

VENDIM
Nr. 321, datë 15.4.2015

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “DALJA URA E VASHËS-BULQIZË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Dalja Ura e Vashës - Bulqizë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 5 239 726 (pesë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, nga të cilat:
 - a) për tokë “arë”, me sipërfaqe 3 719 m², me vlerën 576 445 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë;
 - b) për tokë “truall”, me sipërfaqe 1 060 m², me vlerën 675 220 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet) lekë;
 - c) për “objekte”, me vlerën 3 988 061 (tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, prej 5 239 726 (pesë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar).
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
 7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënim “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.
 9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
"DALJA URA E VASHËS-BULQIZË" fshati Plan i Bardhë

N r	Emri	Atësi a	Mbie mri	Zon a Kad astr.	Nu mri Pasu risë	TOKË ARË			TOKË TRUALL			OBJE KTE vlera	VLERA TOTAL E (LEKË)	Shënime
						Sipërf aqja (m2)	Çmimi (lekë/ m2)	Vle ra lek ë	Sipërf aqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vle ra lek ë			
1	SADI K	HAS N	ALLA	2982	153/ 1	294	155	455 70					45570	Konfirmim ZVRPP
2	SADI K	HAS N	ALLA	2982	153/ 4							521711	521711	Konfirmim ZVRPP
3	DEMR	AHM ET	SALL AKU	2982	134/ 5	222	155	344 10					34410	Konfirmim ZVRPP
4	GEZI M	ARIF	SALL AKU	2982	165/ 6	295	155	457 25					45725	Konfirmim ZVRPP
5	GEZI M	ARIF	SALL AKU	2982	136	395	155	612 25					61225	Konfirmim ZVRPP
6	GEZI M	ARIF	SALL AKU	2982	135/ 2	278	155	430 90					43090	Konfirmim ZVRPP
7	RRAH MAN	REX HEP	BETA	2982	124/ 7	129	155	199 95					19995	Konfirmim ZVRPP
8	RRUZ HDI	BAJR AM	BETA	2982	124/ 1	248	155	384 40					38440	Konfirmim ZVRPP
9	HIKE	MIFT AR	JAUR RI	2982	31/3		155		300	637	191 100	44726 0	638360	Konfirmim ZVRPP
10	B(PRO N)	ZELI HE	KUK A	2982	31/4		155		197	637	125 489	731174	856663	Konfirmim ZVRPP
11	BAJR AM	HALI T	SKOR DHA	2982	26/7	26	155	403 0					4030	Konfirmim ZVRPP
12	HAJR ULLA	MIFT AR	SALL AKU	2982	155/ 2	90	155	139 50					13950	Konfirmim ZVRPP
13	B(PRO N)	ABDI	KRRI KU	2982	239/ 2	595	155	922 25	300	637	191 100		283325	Konfirmim ZVRPP
14	B(PRO N)	LULZ IM	KRRI KU	2982	240/ 1	1050	155	162 750					162750	Konfirmim ZVRPP
15	XHAF ER	HYS EN	KRRI KU	2982	239/ 1	97	155	150 35	112	637	713 44		86379	Konfirmim ZVRPP
16	KADR I	HAM IT	LIK ETA	2982	26/1 0		155		81	637	515 97		51597	Konfirmim ZVRPP
17	HYSE N	MEH MET	TABA	2982	152/ 2				70	637	445 90	22879 16	2332506	Konfirmim ZVRPP
		SHU MA				3719		576 445	1060		675 220	39880 61	5,239,72 6	